



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Maj 2021

Nr. 358

VENDIM

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË QËNDRESËS QYTETARE PËR SHKELJE TË PARASHIKUARA NË KODIN ZGJEDHOR DHE VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË KOMISIONIT RREGULLATOR, NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, NDAJ KANDIDATES PËR DEPUTETE ZJ. GERTA DURAKU

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

VËREN:

Referuar nenit 19, pika 1 shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 7 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejt në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e “Qëndresës Qytetare” ndaj kandidates për deputete, zj. Gerta Duraku, për një aktivitet të zhvilluar prej saj në shkollën e mesme të bashkuar “Shemri” Kukës, si në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, edhe pse ka përfunduar afati 60 ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, pasi pritet edhe një përgjigje nga Zyra Vendore Arsimore Kukës, rëndësia e së cilës është thelbësore për shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

V E N D O S:

- 1- Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të “Qëndresës Qytetare” për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidates për deputete zj. Gerta Duraku.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

